REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 2300/1 Prot. Vlorë më, 22.10.2026

VENDIM

Nr. 28, datë 22/10/2026

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE TË SHPËRNDARJES SË FONDEVE ORGANISATIONAL SUPPORT (OS) NË KUADËR TË PROJEKTEVE ERASMUS+ KA171

Rektorati i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në mbështetje të nenit 40, nenit 3, pika 3, dhe nenit 49, pika 1, shkronja "ë", të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 25, pika 1, shkronja "ë", dhe nenit 26, pika 3, shkronja "b", të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 15 të Rregullores së Brendshme të Universitetit; të Rregullores Financiare të Universitetit; si dhe referuar propozimit të Drejtorisë së Kërkim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët, nr. 2825 prot., datë 15.10.2026, Rektorati i UV-së, në mbledhjen e datës 22.10.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e shpërndarjes së fondeve *Organisational Support (OS)*, në kuadër të projekteve Erasmus+ KA171, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, për miratim përfundimtar.
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof.Dr. Aurela Saliaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI – VLORË

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

Partneritete të krijuara dhe zhvilluara me kontribut të drejtpërdrejtë të personelit akademik:

Përfituesit	Shpërndarja në përqindje
Koordinatori i marrëveshjes	40% e fondit të parashikuar
Aktivitete për Erasmus+ KA171, material promocionale	60% e fondit të parashikuar

Partneritete të iniciuara nga personeli i Sektorit të marrëdhënieve me Jashtë

Përfituesit	Shpërndarja në përqindje
Personeli i Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë	40% e fondit të parashikuar
Aktivitete për Erasmus+ KA171, material promocionale	60% e fondit të parashikuar